



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



**Raporti**  
**mbi trajtimin e ankesave dhe**  
**sugjerimeve të sipërmarrjes**  
**për muajin korrik 2019**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KRYEMINISTRIA

### MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, lejomëni të ndaj me ju raportin e muajit korrik 2019 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Ndër të tjera, këtë muaj i kemi kushtuar rëndësi edhe sektorit të arsimit privat, ku në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë kemi zhvilluar takime konstruktive. Gjithashtu, negocium së bashku me përfaqësuesit e importuesve dhe distributorëve të duhanit në lidhje me ndryshimet e propozuara në Ligjin për Mbrojtjen e Shëndetit nga produktet e duhanit, duke arritur në dakordësimin e ndryshimeve si për mbrojtjen e shëndetit por edhe për bizneset e këtij sektori. Në muajin korrik janë organizuar një sërë takimesh me bizneset e ndikuara nga ndryshime në paketën fiskale përsa i përket taksës së lëndës së parë që përdoret për prodhimin e produkteve të plastikës. Ky proces u finalizua me miratimin e ndryshimeve ligjore në parlament.

Në kuadër të krijimit të urave të komunikimit ndërmjet bizneseve shqiptare dhe atyre kroate, u mbajt Forumi i biznesit Shqipëri-Kroaci, i cili ishte një dëshmi e vullnetit të përbashkët por edhe një mundësi mjaft e mirë ku prezantuam vendin tonë, potencialet dhe përpjekjet tona në drejtim të përmirësimit të klimës së biznesit.

Gjatë prezantimit për herë të parë nga Delegacioni Evropian në Shqipëri të Këshillit Evropian të Inovacionit dhe në përputhje me angazhimin tonë të vazhdueshëm ndaj shoqërive start-up, u diskutua mbi sfidat e hasura dhe mundësitë e reja për përkrahjen dhe zhvillimin e këtyre shoqërive.

Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,  
Eduard Shalsi



## Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.1	MM	11.07.2018	Subjekti kërkon kryerjen e pagesës për shërbimet e kryera në fushën e Emergjencave Civile.	Në proces
Nr.2	Bashkia - Qarku Shkodër	12.01.2019	Subjekti kërkon adresim ose sugjerim te procedurave që duhet të ndiqen përsa i përket transportit urban dhe marrëdhënieve me Bashkinë.	Në proces
Nr.3	MTM	01.02.2019	Subjekti kërkon asistencë për pajisjen me lejen mjedisore dhe përgjigje ndaj kërkesës online.	Trajtuar me zgjidhje
Nr.4	Kryeministria	22.02.2019	Subjekti kërkon përgjigje mbi procedurën e prokurimit me objekt "Prishje i ish Frigoriferit në Vlorë", ankuesi shprehet se KPP nuk pranon ankesën e tyre.	Trajtuar me përgjigje
Nr.5	MFE	05.02.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mungesën e zgjedhjeve në Dhomën e Tregtisë.	Trajtuar me përgjigje
Nr.6	MBZHR	17.02.2019	Kërkesë për interpelancë.	Në proces
Nr.7	MIE	22.02.2019	Subjekti ankohet për pjesëmarrje në procedurën konkurruese leje kërkim-zbulimi.	Trajtuar me zgjidhje
Nr.8	Bashkia - Qarku Korçë	25.02.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mosshlyerjen e detyrimeve për projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale.	Në proces
Nr.9	Bashkia - Qarku Tiranë	24.02.2019	Subjekti kërkon anulim dhe rishikim vendimi nga ana e Bashkisë.	Në proces
Nr.10	MFE	01.03.2019	Subjekti pretendon se ka pasur veprime arbitrare nga dogana në lidhje me rivlerësimin e deklaratave doganore.	Trajtuar me zgjidhje
Nr.11	MFE	06.03.2019	Subjekti ankohet për penaltet të lartë nga administrata tatimore.	Trajtuar me përgjigje
Nr.12	MIE	14.03.2019	Subjekti kërkon përmirësim të rrugës për të aksesuar biznesin.	Në proces
Nr.13	MFE	15.03.2019	Subjekti ankohet për kushte diskriminuese në lejimin e ushtrimit të profesionit arkitekt dhe inxhinier.	Trajtuar me zgjidhje
Nr.14	MFE	21.03.2019	Subjekti kërkon përfshirjen e fidanëve të shafranit në listën e inputeve bujqësore të përjashtuara nga TVSH-ja.	Trajtuar me përgjigje

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 15	Bashkia - Qarku Gjirokastrë	25.03.2019	Subjekti ankohet në lidhje me shkeljen e procedurave ligjore në ndërtimin e linjave të rrjetit të shpërndarjes.	Në proces
Nr. 16	MFE	28.03.2019	Subjekti denoncon konkurrencën e pandershme që zhvillohet nga bizneset online të paregjistruara në QKB që operojnë përmes Instagram & Facebook.	Në proces
Nr. 17	MFE	10.04.2019	Subjekti ankohet për detyrimet tatimore si dhe ndaj Bashkisë.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 18	MIE	11.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me procedurat e miratimit të një impianti fotovoltaik.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 19	MFE	15.04.2019	Subjekti kërkon të zhvillojë një takim me Zv/kryeministrin.	Në proces
Nr. 20	MTM	15.04.2019	Subjekti kërkon miratimin e procedurës dhe përditesimet përkatëse në kadastrën e pyjeve.	Në proces
Nr. 21	Bashkia - Qarku Vlorë	15.04.2019	Subjekti kërkon mbështetje për ngritjen e qendrës së zhytjes në Vlorë.	Në proces
Nr. 22	Bashkia - Qarku Dibër	18.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mos likuidimin e faturave dhe dëmin ekonomik të shkaktuar nga Bashkia Klos për objekte tenderimi të përfunduara.	Në proces
Nr. 23	MIE	23.04.2019	Subjekti ankohet për mos-kthim përgjigje nga ana MIE.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 24	MFE	26.04.2019	Subjekti kërkon asistencë për përfitimin e një granti për realizimin e biznesit të tij.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 25	MFE	26.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një kontroll tatimor ndaj subjektit të çregjistruar.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 26	MD	27.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me pamundësinë e legalizimit të një kabanoni në Durres.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 27	Bashkia - Qarku Vlorë	30.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me moslargimin e një barake të shkatërruar nga bashkia.	Në proces
Nr. 28	Bashkia - Qarku Tiranë	30.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një gjobë vendosur kundrejt një NIPT-i pasiv, administratori i të cilit ka vdekur.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 29	Bashkia - Qarku Pogradec	02.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për zhblokimin e rrugës për të aktiviteti i biznesit të tij.	Trajtuar me përgjigje

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 30	MIE	01.05.2019	Subjekti kërkon pajisjen me leje të përdorimit të ujit për HEC-e ekzistuese e të ndërtuara nga shteti shqiptar por që i janë dhënë shoqërisë koncesionare.	Në proces
Nr. 31	MTM	13.05.2019	Subjekti ankohet për pezullim aktiviteti.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 32	MBZHR	14.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me ashpërsimin e denimeve për sigurinë ushqimore, kur nuk krijohen kushte të përshtatshme nga qeveria për përmirësimin e sigurisë ushqimore.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 33	MB	17.05.2019	Subjekti kërkon lëshimin e licencave të eksportit dhe interpretimin juridik të urdhrit 661.	Në proces
Nr. 34	MBZHR	17.05.2019	Subjekti kërkon përgjigje në lidhje me aplikimin e kontrollit për jetëgjatësinë nga ana e AKU.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 35	Bashkia - Qarku Kavajë	22.05.2019	Subjekti kërkon marrjen e certifikates së përdorimit e cila i është mohuar.	Në proces
Nr. 36	MZHBR	22.05.2019	Subjekti kërkon përgjigje nga AKU në lidhje me gjobat dhe bllokimin e mallit nga ana e AKU.	Në proces
Nr. 37	MFE	24.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për adresimin e faturave për zhvillimin e sistemit të të dhënave akomoduese turistike.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 38	MIE	24.05.2019	Subjekti kërkon një interpretim në lidhje me zbatimin e nenit 22 të Ligjit nr. 7/2017 'Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme'.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 39	MIE	24.05.2019	Subjekti kërkon pajisjen me leje të përdorimit të ujit për HEC-e ekzistuese e të ndërtuara nga shteti shqiptar por që i janë dhënë shoqërisë koncesionare.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 40	MD	27.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për rihapjen e aktivitetit.	Në proces
Nr. 41	MBZHR	30.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mosmarrjen e një leje ndërtimi në fushën e agrobiznesit.	Në proces
Nr. 42	MSHMS	31.05.2019	Subjekti kërkon rishikim të procedurave për publikimin e librave shkollorë.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 43	MIE	31.05.2019	Subjekti kërkon informacion mbi zbatimin e detyrimeve kontraktuale të kontratës koncensionare të HEC-Malind 2,3.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 44	MFE	30.05.2019	Subjekti ankohet për bllokim të llogarive bankare nga tatimet.	Në proces
Nr. 45	Bashkia - Qarku Elbasan	06.04.2019	Subjekti ankohet për procedurat në tendera, mungesë konkurrence.	Në proces
Nr. 46	MFE	10.06.2019	Subjekti kërkon takim me DPD ne lidhje me një gjobë të vendosur në mënyrë të padrejtë.	Në proces
Nr. 47	MIE	10.06.2019	Subjekti pretendon se nuk janë konsultuar në momentin e hartimit të projektit.	Në proces
Nr. 48	Qarku Durrës	10.06.2019	Subjekti kërkon informacion në lidhje me planin zhvillimor të zonës.	Në proces
Nr. 49	MBZHR	10.06.2019	Subjekti ankohet në lidhje me gjobitje të padrejtë në fushën e peshkimit.	Në proces
Nr. 50	MIE	09.06.2019	Subjekti ankohet në lidhje me procedurat e prokurimeve.	Në proces
Nr. 51	MFE	11.06.2019	Subjekti CEMA shpk kërkon të punësoje disa nga azilantet iranian të vendosur pranë fabrikës së tyre, dhe kërkon të dijë nëse kjo është e mundur.	Në proces
Nr. 52	Komisioni i Ligjeve	11.06.2019	Subjekti kërkon disa ndryshime në Kodin Penal për sigurinë ushqimore.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 53	Bashkia - Qarku Durrës	12.06.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një ndërtim të parregullt që ndikon në biznesin e tyre.	Në proces
Nr. 54	MFE	12.06.2019	Subjekti kërkon ri-shqyrtim të vendimit të zyrës doganore.	Në proces
Nr. 55	MBZHR	18.06.2019	Subjekti kërkon të shfrytëzojë ujrat e rezervuarit të Belesovës për prodhimin e energjisë elektrike.	Në proces
Nr. 56	MBZHR	18.06.2019	Subjekti kërkon anulim dhe ndryshim të disa masave administrative "dënim me gjobë".	Në proces
Nr. 57	Bashkia - Qarku Tiranë	18.06.2019	Subjekti ankohet për taksat vendore.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 58	MBZHR	19.06.2019	Subjekti pretendon se konkurrentet nuk plotësojnë kushtet për prokurimin publik "Blerje automjetesh".	Në proces
Nr. 59	MIE	19.06.2019	Subjekti ankohet lidhur me procedurat e prokurimit.	Në proces
Nr. 60	MIE	19.06.2019	Subjekti kërkon informacion me statusin e çështjes gjyqësore në Apel.	Trajtuar me përgjigje

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 61	Bashkia - Qarku Tiranë	19.06.2019	Subjekti kërkon informacion në lidhje me Projektin e Bashkisë së Tiranës në lidhje me Ujësjetësinë e Gurit të Bardhë.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 62	MSHMS	20.06.2019	Subjekti ankohet për gjobë të vendosur nga ISHSH.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 63	MFE	20.06.2019	Subjekti kërkon shtyrjen e afatit të Magazinës së Lirë ML-13, miratimin e shtimit të kapacitetit/sipërfaqes mbajtëse të depozitave të karburantit në autorizimin e për magazinë të lirë.	Në proces
Nr. 64	MFE	21.06.2019	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH-së brenda afateve të caktuara.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 65	MD	21.06.2019	Subjekti kërkon leje për përdorimin e plazhit përpara pronës së tij.	Në proces
Nr. 66	Ministria e Drejtësisë	24.06.2019	Subjekti kërkon asistencë për aplikimin në hipotekë.	Në proces
Nr. 67	MSHMS	25.06.2019	Subjekti denoncon autobotet që tregojnë ujë të pijshëm jashtë kushteve higjieno-sanitare.	Në proces
Nr. 68	MBZHR	25.06.2019	Subjekti kërkon asistencë në lidhje me problematikat e hasura në Liqenin e Vaut të Dejës për biznesin e tij.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 69	MIE	26.06.2019	Subjekti kërkon që MIE të marrë një vendim për zbardhjen e lejes së ndërtimit në lidhje me ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik.	Në proces
Nr. 70	MFE	26.06.2019	Subjekti ankohet në lidhje me përdorimin e çmimeve të pasakta nga ana e doganës për zhgodanimin e produkteve.	Në proces
Nr. 71	APP	26.06.2019	Subjekti ankohet mbi procedurat e prokurimeve me shkelje nga AK.	Në proces
Nr. 72	MIE	27.06.2019	Subjekti ankohet në lidhje me funksionimin e kapitenerisë në Vlorë.	Në proces
Nr. 73	MIE	02.07.2019	Subjekti ankohet në lidhje me përfundimin e një kontrate qiraje në mënyrë të padrejtë.	Në proces
Nr. 74	MIE	02.07.2019	Subjekti kërkon listë të drejtuesve teknik të cilet kanë licensë si mbikqyres dhe kolaudues punimesh.	Në proces



Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 75	MD	03.07.2019	Subjekti pretendon se drejtori i Agjencise së Kadastres-Vlorë, në kundërshtim me ligjin nuk i jep certifikatat e pronësisë për një objekt.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 76	MIE	04.07.2019	Subjekti kërkon anulim dhe rishikim vendimi nga ana e Bashkisë.	Në proces
Nr. 77	MD	10.07.2019	Subjekti ankohet për zvarritje të dhënies së një certificate pronësie nga ana e ZRPP, pasi ky i fundit kërkon një dokument i cili është dorëzuar më parë nga subjekti.	Në proces
Nr. 78	MTM	10.07.2019	Subjekti ankohet në lidhje me sjelljen dhe punën e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit në Durrës	Në proces
Nr. 79	MFE	10.07.2019	Subjekti kërkon rishikimin e VKM nr. 437 date 26/06/2019.	Në proces
Nr. 80	MIE	11.07.2019	Subjekti kërkon miratimin paraprak për ndërtimin e parkut fotovoltaiik Betanie, Bashkia Fushë-Krujë.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 81	MFE	12.07.2019	Subjekti ankohet për vonesa në rimbursimin e TVSH-së.	Në proces
Nr. 82	MBZHR	13.07.2019	Subjekti kërkon financim/kredi të butë pas një fatkeqesie natyrore që ka ndërprerë aktivitetin.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 83	Bashkia Berat	16.07.2019	Subjekti me aktivitet punime mermeri ankohet se varrezat e zonës i janë dhënë për administrim për një periudhë kohore prej 5 vjetesh një personi, sipas subjektit, me influencë.	Në proces
Nr. 84	MFE	17.07.2019	Subjekti denoncon disa subjekte të cilat sipas tij merren me kontrabandë.	Në proces
Nr. 85	Bashkia Tiranë	19.07.2019	Subjekti ankohet për mos kthim përgjigje nga ana e Bashkisë Tiranë.	Në proces
Nr. 86	OSHEE	19.07.2019	Subjekti ankohet për faturim të padrejtë energjie dhe kërkon kompensim.	Në proces
Nr. 87	Inspektoriati shtetëror teknik dhe industrial	19.07.2019	Subjekti kërkon heqjen e gjobave dhe barrës hipotekore në lidhje me karburant të kualifikuar si me cilësi të dobët.	Në proces
Nr. 88	MIE	22.07.2019	Subjekti kërkon anulimin e VKM NR.835, datë 15.2.2009.	Në proces
Nr. 89	KPP	24.07.2019	Subjekti kërkon anulimin e vendimit të Autoritetit Kontraktor.	Në proces
Nr. 90	Qarku Vlorë	24.07.2019	Subjekti ankohet për disa ndërtesa përpara hotelit që është duke ndërtuar, dhe që i prishin imazhin e zonës.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 91	MFE	24.07.2019	Subjekti ankohet për gjobëvënie me tendencë nga ana e administratës.	Në proces
Nr. 92	Bashkia Tiranë	24.07.2019	Subjekti kërkon të hiqen nga sistemi gjobat të cilat i ka paguar nëpërmjet bankës.	Në proces
Nr. 93	MFE	25.07.2019	Subjekti ankohet për mos kompensimin e TVSH-së brenda afateve.	Në proces
Nr. 94	MiSHMS	30.07.2019	Subjekti kërkon të zhvillojë një takim me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.	Në proces
Nr. 95	MFE	01.08.2019	Subjekti ankohet në lidhje me parregullsi në pagesat e tatimeve.	Në proces
Nr. 96	Kryeministria	08.05.2019	Subjekti kërkon lejimin e ushtrimit të aktivitetit të ndërtimit të jahteve në zonat e konsideruara "brigje".	Në proces
Nr. 97	MFE	21.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me situatën pothuajse monopol në treg në lidhje me shoqëritë inspektuese të ashensorëve.	Në proces
Nr. 98	AMF	14.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me falimentimin e shoqërisë dhe problematikat e shkaktuara të grupit respektiv.	Në proces

